

Deklarata e Besfort Shala

Gjatë vitit akademik 2021/22, kam ndjekur studimet në programin e magjistraturës për matematikë në Universitetin e Oxfordit në Angli. Për shkak të kostos së lartë të shpenzimeve të shkollimit, kjo është bërë e mundur vetëm falë ndihmës së shume njerëzve të vullnetit të mirë dhe institucioneve si Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në veçanti. Kjo ndihmë ka pasur një rol shumë të rëndësishëm në sigurimin e stabilitetit financiar gjatë programit.

Duke pasur si synim zhvillimin e përbashkët të shoqërisë sonë në matematikë, kam ndihmuar në procesin e përfitimit të bursave të plota në Universitetin e Primorskës në Slloveni për katër studentë nga Kosova, dy prej në vitin akademik 2021/22 e dy të tjerë në vitin akademik 2022/23. Shpresoj që do të punojmë bashkarisht që të krijohen e të vazhdoen mekanizma konkret për ndihmën ndaj nxënësve të dalluar.

Gjatë studimeve, kam pasur nderin të punoj në temën e diplomës nën udhëheqjen e Profesorit James Maynard, tani posedues i Fields Medal, që njihet si ekuivalenti i çmimit Nobel për matematikë. Për temën e diplomës, sikur edhe në secilin provim nga lëndët e rregullta, jam vlerësuar me notën maksimale, përkatësisht klasifikimin Distinction. Përtej studimeve, kam prezentuar në seminarin e studentëve të doktoraturës "Oxford Junior Number Theory Seminar", si dhe kam marrur pjesë në konferencën për studentë "Tomorrow's Mathematicians Today 2022". Në këtë të fundit, prezentimi im ka hyrë në listën e ngushtë për prezentimin më të mirë.

Përtej matematikës, kam marrur pjesë rregullisht në darkat akademike të organizuara nga Reuben College, të fokusuara në diskutime mbi ndryshimet klimatike, pandemitë, normat etike dhe inteligjencën artificiale. Në këto diskutime, jam munduar t'i njoftoj bashkëbiseduesit me Kosovën, duke ofruar një perspektivë më ndryshe nga prizmi i një vendi në zhvillim. Qëllimi final i gjithë kësaj është kontribuimi për zhvillimin e arsimit në Kosovë dhe matematikës në veçanti.